



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **“Westec” sh.p.k**

Adresa: Tiranë Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga Lule Bore, Banesë Private Nr.17

Për: **“Anton Marku”p.f**

Adresa: Durrës Kodër Thuman Derven Banesë prvate dy katëshe,në të majtë të rrugës Fushë Kruje-Laç,Km 4.

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur-Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-59292-05-28-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Materiale Elektroda,Oksigjen për nevoja të Shoqërisë”

Fondi limit: 11,994,667(njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)lekë pa tvsh.

Shumatorja e çmimeve për njësi 1,243,793(një milion e dyqind e dyzetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre)lekë pa tvsh.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.32. Datë 01.06.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“INPLY” sh.p.k**

L51503032Q

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera
e njëzetë)lekë pa tvsh.

309,520 (treqind e nëntë mijë e pesëqind

2. **“GTS(Gazra Teknike Shqiptare)” sh.p.k** J61905015B

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 638,400(gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind)lekë pa tvsh

3. “Westec”sh.p.k L01621002O

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1,075,990(një milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

4. “Anton Marku”p.f L03817203B

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1,079,041(një milionë e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzetë e një) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. **“INPLY” sh.p.k** L51503032Q

2. **“GTS(Gazra Teknike Shqiptare)” sh.p.k** J61905015B

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “INPLY” sh.p.k me shumatore të çmimeve për njësi 309,520(treqind e nëntë mijë e pesëqind e njëzetë)lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik , nga ku rezultoi si më poshtë cituar:

Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 9 dhe 10 si më poshtë cituar:

9. Ofertuesi duhet të dorëzoje dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise	Emertimi i	Referenca ne katalogje/	Shënimet
----	-----------------------	--------------------	------------	-------------------------	----------

	prodhuese, adresa , ëeb-siti	katalogut	KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	
--	---------------------------------	-----------	--	--

Emërtimi I produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

10.Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si me poshtë:

1	2	3	4
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Njësia
1	Elektroda d=3,25 mm(SUPER B)	1	kg
2	Elektroda gize	1	kg
3	Elektroda alumin(saldim skatulla alumini)	1	pako 2 kg
4	Elektroda inox (per saldim botet e ujit inox).	1	pako
5	Boracio(per saldimin me oksigjen-antikorrodues)	1	kg
6	Maska saldimi elektrik	1	cope
7	Kominoshe per saldatorët	1	cope
8	kanela saldimi per ngjitje	1	cope
9	kanela prerje oksigjeni	1	cope
10	Reduktor oksigjeni	1	cope
11	Reduktor acitileni	1	cope
12	Valvol moskthimi acitilen reduktori	1	cope
13	Valvola moskthimi oksigjen te reduktorit	1	cope

14	Valvol moskthimi acitileni te tubove	1	cope
15	Maja prerje (0-75) oksigjeni	1	seri
16	Kabull saldimi	1	ml

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga në SPE, rezulton se operatori ekonomik INPLY sh.p.k për produktet objekt prokurimi ka paraqitur autorizim distributori lëshuar nga kompania Cobalt sh.p.k me anë të cilës autorizon kompaninë INPLY sh.p.k për procedurën objekt prokurimi. Gjithashtu operatori ekonomik INPLY sh.p.k ka paraqitur autorizim prodhuesi të lëshuar nga kompania Esab për kompaninë Cobalt sh.p.k.

Referuar ofertës teknike të dorëzuar në sistemin elektronik operatori ekonomik INPLY sh.p.k ka plotësuar rubrikën e emërimit të kompanisë prodhuese në të cilën evidentohet se për produktet nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, nr.11, nr.12, nr.13, nr.14, nr.15, nr.16, nr.17, nr.18, nr.19, ka plotësuar kompaninë ESAB.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi mori në shqyrtim mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik INPLY ditën e zhvillimit të tenderit 22.06.2020 rezulton se për produktin nr.11 (kanella prerje oksigjeni) rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetohet se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Esab”

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, edhe për mostrën nr.7 (boraçio) rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetohet se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Esab” gjithashtu sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik INPLY sh.p.k. OK FLUX 350 rezultoi se ky lloj Fluxi shërben për saldime me makineri gjysautomatike me hark të zhytur dhe nuk shërben për saldime në temperatura të ulta me oksigjen sipas kërkesës së AK.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, edhe për mostrën nr.9 (kanella prerje oksigjeni) rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetohet se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Esab”.

Në rastin konkret, mostra e paraqitur për artikullin “kanella prerje oksigjeni” nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak të mungesës të markës të prodhuesit.

Gjatë shqyrtimit të mostrës të dorëzuar nga operatori ekonomik INPLY për llojin e mallit elektrodë super B referuar kodit në mostër A SB-248 të verifikuar nga KVO rezulton se kompozimi kimik i elementit Mn (Mangan) është në vlerën 0,90%, ndërsa AK ka kërkuar elementin e Manganit në vlerën 1-1.1%.

Gjithashtu referuar kodit përkatës A SB-248 për zërin nr.3 të verifikuar në mënyrë elektronike rezulton ti përkasë një prodhuesi përkatësisht ASKAYNAK e cila rezulton një kompani turke dhe jo kompanisë ESAB.

Sqarojmë se operatori ekonomik INPLY sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori në sistemin elektronik për procedurën objekt prokurimi për kompaninë e mësipërme ASKAYNAK.

Në rastin konkret, mostra e paraqitur për artikullin e sipërcituar nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak se dokumentacioni në sistemin elektronik është paraqitur si prodhues ESAB ndërsa në mostrat e dorëzuara rezulton prodhues kompania ASKAYNAK.

Gjithashtu edhe në katalogjet e paraqitura në SPE të prodhuesit ESAB vërehet se kompozimi kimik i elementit Mn (Mangan) është në vlerën 0,60% pra nën vlerën e kërkuar nga AK.

Gjatë shqyrtimit të mostrës të dorëzuar nga operatori ekonomik INPLY për llojin e mallit elektrodë inoxi referuar kodit në mostër AS P-308 MN të verifikuar nga KVO rezulton se malli një fjalë i përket një kompani prodhuese ASKAYNAK(kompani turke) dhe jo ESAB ashtu siç është plotësuar në ofertën teknike të dorëzuar nga operatori ekonomik INPLY sh.p.k.

Sqarojmë se operatori ekonomik INPLY sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori në sistemin elektronik për procedurën objekt prokurimi për kompaninë e mësipërme ASKAYNAK.

Referuar verifikimit nëpërmjet kodit të paraqitur në mostër rezulton se mungon elementi i Molibden 2-3%, çka bie në kundërshtim me specifikimet e kërkuara nga AK për materialet e elektrodave të inoxit.

Në rastin konkret, mostra e paraqitur për artikullin e sipërcituar nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak se dokumentacioni në sistemin elektronik është paraqitur si prodhues ESAB ndërsa në mostrat e dorëzuara rezulton prodhues kompania ASKAYNAK.

Gjithashtu referuar ofertës teknike të pasqyruar në sistemin elektronik për artikujt reduktor oksigjeni dhe reduktor acitileni operatori ekonomik INPLY sh.p.k ka plotësuar emrin e prodhuesit ESAB.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë verifikimit të mostrave vëren se prodhuesi i materialeve të mësipërm i përket prodhuesit OXYTURBO për të cilën rezulton se operatori ekonomik nuk ka

paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori si dhe nuk ka plotësuar ndonjë rubrikë të ofertës ekonomike se është i autorizuar nga prodhuesi OXYTURBO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë.

Gjithashtu referuar ofertës teknike të pasqyruar në sistemin elektronik për artikujt Valvol moskthimi acitilen reduktori, Valvola moskthimi oksigjen te reduktorit, Valvol moskthimi acitileni te tubove operatori ekonomik INPLY sh.p.k ka plotësuar emrin e prodhuesit ESAB.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë verifikimit të mostrave vëren se operatori ekonomik INPLY sh.p.k ka dorëzuar 3 mostra të njëjta përkatësisht Valvol moskthimi acitileni te tubove.

Nga verifikimi i mostrave rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur valvol moskthimi Valvol moskthimi acitilen reduktori ,Valvola moskthimi oksigjen te reduktorit çka bie në kundërshtim me kushtet e kërkuara nga AK.

Referuar mostrës Valvol moskthimi acitileni te tubove rezulton ti përkasë prodhuesit OXYTURBO e cila rezulton të jetë kompani italiane.

Theksojmë se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori si dhe nuk ka plotësuar ndonjë rubrikë të ofertës teknike se është i autorizuar nga prodhuesi OXYTURBO, duke mos qënë pjesë e dokumentacionit elektronik të procedurës objekt prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, edhe për mostrën elektrodë gize (nr.4)rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetojë se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Esab” ashtu siç operatori ekonomik e ka plotësuar në ofertën teknike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë.

Për artikullin Elektroda alumin(saldim skatulla alumini) nr.5 në ofertën teknike ka plotësuar se produkti në fjalë I përket kompanisë prodhuese ESAB.

Gjatë verifikimit të mostrës Elektroda alumin(saldim skatulla alumini) referuar mbishkrimit të produktit rezultoi se i përket kompanisë Selectarc(kompani franceze) dhe jo kompania ESAB ashtu siç është plotësuar në ofertën teknike të paraqitur në SPE.

Sqarojmë se operatori ekonomik INPLY sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori në sistemin elektronik për procedurën objekt prokurimi për kompaninë e mësipërme

Selectarc(kompani franceze).

Referuar verifikimit nëpërmjet kodit të paraqitur në mostër (Al 105, kompania prodhuese Selectarc) rezulton se përqindja e silicit është 5% ndërkohë që AK ka kërkuar që përqindja e silicit të jetë 10%-12% , çka bie në kundërshtim me specifikimet e kërkuara nga AK për materialet e elektrodave të aluminit.

Për artikujt maska saldimi elektrike, Kominoshe per saldatorët, kanela saldimi per ngjitje referuar mostrave të dorëzuar rezultoi se maskat e saldimit I përkasin kompanisë INCO(firmë kineze), për kombinoshet I përkasin kompanisë FUMAX(kompani shqiptare), ndërsa për kanellat e saldimit rezulton ti përkasin kompanisë Le LORRAIN(kompani franceze).Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik referuar ofertës teknike rezulton se operatori pjesëmarrës ka plotësuar si kompani prodhuese ESAB.

Ashtu siç kemi përmendur dhe më lart operatori ekonomik INPLY sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori në sistemin elektronik për procedurën objekt prokurimi për kompanitë e mësipërme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë.

Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** .

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “GTS” sh.p.k me shumatore të çmimeve për njësi 638,400(gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind)lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga në SPE, rezulton se operatori ekonomik GTS(Gazra Teknike Shqiptare)sh.p.k për produktin objekt prokurimi valvol moskthimi acitileni të tubove ka plotësuar ne ofertën teknike si kompani prodhuese GCE.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi mori në shqyrtim mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik GTS(Gazra Teknike Shqiptare) ditën e zhvillimit të tenderit 22.06.2020 rezulton se për produktin nr.14 produkti i përket kompanisë IBEDA dhe jo kompanisë GCE siç është plotësuar në ofertën teknike.

Sqarojmë se operatori ekonomik GTS sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori në sistemin elektronik për procedurën objekt prokurimi për kompaninë e mësipërme IBEDA.

Në rastin konkret, mostra e paraqitur për artikullin e sipërcituar nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak se dokumentacioni në sistemin elektronik është paraqitur si prodhues GCE ndërsa në mostrat e dorëzuara rezulton prodhues kompania IBEDA.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, edhe për mostrën elektrodë gize (nr.4), elektrodë nr.5 rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetohet se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Siderarco” ashtu siç operatori ekonomik e ka plotësuar në ofertën teknike.

Gjithashtu artikulli, *Kominoshe per saldatorët*, nuk është paraqitur nga operatori ekonomik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë.

Edhe nëse i referohemi katalogjeve të kompanisë prodhuese Siderarco vërehet se elementët kimikë të paraqitura operatori ekonomik GTS sh.p.k nuk plotësojnë asnjë prej specifikimeve të kërkuara nga AK.Konkretisht AK ka kërkuar

Elektroda Gize 3.2mm

Dimensioni 3.2*350mm

Kompozimi kimik ne % te bashkimit te metalit:

C	Si	Mn	P	S	Ni	Cu	Al	Fe
1.4	0.6	0.3	<0.01	<0.01	51.6	0.6	<0.1	Rest

Të dhënat ,cilësitë mekanike

Testi elasticitetit fortësie							
T	Rel/Rp 0,2 MPa	Rp 1,0 MPa	Rm MPa	A(Lo=5d) %	Z %	ËBH PËHT	Verejtje
20°C	≥290		≥550	≥10			

Testi I ndikimit temp						
T	Ndikimi i energjisë KV/J	Mesatare	Zgjerimi anesor mm	Thyerje %	ËBH PËHT	Verejtje
20°C	≥ 20					

Referuar katalogjeve vërehet se elementët e paraqitur të kompanisë prodhuese Siderarco janë si më poshtë vijon:

C	Si	Mn	Ni	Fe
1	0,7	0.8	53	Rest

Pra lehtësisht vërtetohet se elementi karbon i paraqitur nga operatori është 1 pra më I ulët se 1,4(i kërkuar nga AK), mungon elementi bakër, elementi alumin, mungon elementi fosfor, mungon sqfur, mungojnë të dhënat teknike të cilësitë mekanike çka bie në kundërshtim me specifikimet e kërkuara nga AK.

Për artikullin nr.7 (boraçio) në ofertën teknike ka plotësuar se produkti në fjalë I përket kompanisë prodhuese GCE.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, edhe për mostrën nr.7 (boraçio) rezultoi se kjo mostër nuk disponon asnjë markë prodhuesi në mënyrë që të vërtetojë se produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “GCE.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara.

Për produktin nr.6 elektroda inox referuar edhe katalogjeve të kompanisë prodhuese Siderarco vërehet se nuk ka në përmbajtjen e saj elementin kimik Molibden(Mo)të kërkuara në specifikimet teknike të AK.

Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit

kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në formularin e ofertës teknike për produktin aparat mig mag operatori ekonomik ka deklaruar kompaninë prodhuese Sol Group për të cilët rezulton të ketë paraqitur autorizim prodhuesi.

Referuar specifikimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik GTS sh.p.k vërehet se shkalla e mbrojtjes IP është 21S ndërsa në specifikimet e kërkuara nga AK është kërkuar IP23S.

Sqarojmë se shkalla e mbrojtjes IP shërben për rregullimin e luhatjes të tensionit.Paraqitja e një aparati me shkallë mbrojtje IP më e vogël se çka këkuar AK për rrjedhojë sjell dëmtime të aparaturës dhe vë në rrezik jetën e saldatorit.

Përsa i përket maksimumi i fuqisë hyrëse në KVA operatori ekonomik e ka paraqitur 25 KVA ndërsa AK ka kërkuar maksimumi 13,0/13,3 KVA. Theksojmë se paraqitja e një fuqie hyrëse më të lartë se ajo e kërkuar sjell për rrjedhojë konsumim më të lartë të energjisë elektrike cka sjell shpenzime ekonomike për AK.

Shkalla e izolimit e kërkuar nga AK është shkalla H ndërsa operatori ekonomik për mallin e paraqitur mungon.Sqarojmë se mungesa e shkallës të izolimit H është kusht i domosdoshëm për shkak se aparatura mund të punojë në ambiente që kanë lagështirë të lartë dhe përbën rrezik për punonjës të cilët do të punojnë me këtë aparaturë.Nga ana teknike kërkesa e AK është kërkuar që kjo aparaturë të disponojë procese të saldimit si më poshtë vijon:

MIG/MAG – PULSED MIG/MAG – MMA – TIG DC Lift i cili operatori ekonomik në modelin e dhënë ka ofruar një pajisje e cila ka 2 procese përkatësisht MIG/MAG dhe MMA.Pra vërehet se mungon procesi PULSED MIG/MAG, TIG DC Lift.Gjithashtu mungon programi sinergjik.Autoriteti Kontraktor ka kërkuar për apaturën e sipërcituar:

Cikli i punes MIG / MAG – 40 °C	50 % – 320 A 60 % – 310 A 100 % – 250 A
------------------------------------	---

Operatori ekonomik ka ofruar një aparaturë e cila është 500A.

Theksojmë se paraqitja e një fuqie në dalje më të lartë se ajo e kërkuar sjell për rrjedhojë konsumim më të lartë të energjisë elektrike cka sjell shpenzime ekonomike për AK.

AK ka kërkuar që lidhja të jetë nëpërmjet internetit me qëllim verifikimin e problematikave që mund të lindin gjatë procesit të punës.

Weld @ Net compatible	Po
-----------------------	----

Në produktin e ofruar nga operatori ekonomik GTS sh.p.k vërehet se mungon lidhja e aparaturës me një kompjuter nëpërmjet internetit për problematikat që mund të lindin gjatë procesit të punës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

- “Westec”sh.p.k L01621002O
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1,075,990(një milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.
- “Anton Marku”p.f L03817203B
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1,079,041(një milionë e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzetë e një) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë UKT Sh.a, me adresë , Rruga E Kavajës Ndërtesa Nr,133, Njësia Administrative Nr 6, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **29.06.2020**

Ankesa: **JO**